

**NDËRMARRJA PUBLIKE
“PARQE DHE GJELBËRIME” – SHKUP**

**STATUTI
I NP “PARQE DHE GJELBËRIME” – SHKUP**

Shkup, prill viti 2019

Në bazë të nenit 19 paragrafi (2) pika 1 dhe në bazë të nenit 29 të Ligjit ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 38/1996, 9/1997,6/2002, 19/2002, 40/2003, 49/2006, 22/2007, 83/2009, 97/2010, 6/2012, 119/2013, 41/2014, 138/2014, 25/2015, 61/2015, 39/2016, 64/2018 dhe 35/2019), Këshilli drejtues i NP “Parqe dhe gjelbërime”, në seancën e mbajtur më datën 19.04. të vitit 2019 , solli

STATUTIN E NP “PARQE DHE GJELBËRIME” – SHKUP

1. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Me statutin e Ndërmarrjes publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, prej së afërmi rregullohet organizimi dhe mënyra e realizimit të veprimtarisë, menaxhimi dhe udhëheqja me Ndërmarrjen publike, aktet e përgjithshme dhe procedurat për sjelljen e tyre, si dhe çështje të tjera me rëndësi për realizimin e veprimtarisë dhe funksionimit të ndërmarrjes publike.

Neni 2

Qyteti i Shkupit është themelues i ndërmarrjes publike dhe i gëzon të gjitha të drejtat dhe obligimet të cilat pasojnë nga Ligji dhe dispozitat tjera ligjore.

Neni 3

Ndërmarrja publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, (në tekstin e mëlutjeshëm: ndërmarrja) themelohet me qëllim të realizimit të veprimtarisë komunale me interes publik.

Neni 4

Ndërmarrja publike “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, është formuar me ndarjen e NPK “Komunalec” – Shkup, me vendimin nr. 02-8800/7 të datës 08.10.1992, kurse në Gjykatën ekonomike të rrethit Shkup, ndërmarrja është e regjistruar me aktvendimin me numrin regjistrues 19252/92 më datën 29. 12.1992.

Neni 5

Gjatë funksionimit të Ndërmarrjes, si gjuhë zyrtare janë gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik dhe gjuha shqipe dhe alfabeti i gjuhës shqipe, si dhe gjuha dhe alfabeti të cilin e shfrytëzojnë qytetarët të cilët i përkasin bashkësisë etnike e cila me mbi 20 % merr pjesë në numrin e përgjithshëm të banorëve në Qytetin e Shkupit.

Neni 6

Gjatë punësimit në ndërmarrjen, detyrimisht zbatohen kriteret dhe parimet me të cilët sigurohet përfaqësimi përkatës dhe i drejtë i qytetarëve të cilët i përkasin të gjitha bashkësive etnike, duke mos i cenuar parimet e profesionalitetit dhe kompetencës.

Pozita e të punësuarve në ndërmarrjen rregullohet me akte të posaçme në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligjin për punëtorët e administratës, Ligjin për marrëdhënie të punës dhe marrëveshjet kolektive.

2. FIRMA DHE SELIA

Neni 7

Emri i plotë i ndërmarrjes është:

Јавно претпријатие „Паркови и зеленило“ -Скопје
Ndërmarrja publike „Parqe dhe gjelbërime“ – Shkup

Emërtimi i shkurtër i ndërmarrjes është:

J.P. „Паркови и зеленило“ -Скопје

N.P. „Parqe dhe gjelbërime“ –Shkup.

Neni 8

Selia e ndërmarrjes është në Shkup, në bulevardin “Ilinden” numër 104.

Për ndryshimin e firmës dhe selisë së Ndërmarrjes, vendos Këshilli drejtues i Ndërmarrjes me pëlqimin e marrë prej më parë nga Këshilli i Qytetit të Shkupit.

3. VULA DHE VULA KATRORE

Neni 9

Gjatë punës së saj, Ndërmarrja shfrytëzon vulën dhe vulën katrore.

Vula ka formën e rrethit me diametër prej 32 mm, në të cilin në pjesën e sipërme qëndron teksti: Јавно претпријатие „Паркови и зеленило“ - Скопје, kurse në pjesën e poshtme qëndron teksti: Ndërmarrja publike „Parqe dhe gjelbërime“ – Shkup.

Neni 10

Ndërmarrja posedon edhe vulën katrore me formë të kënddrejtit me dimensione 65 mm x 40 mm dhe në të qëndron i shkruar teksti vijues:

Јавно претпријатие
Ndërmarrja publike
„ПАРКОВИ И ЗЕЛЕНИЛО“
„PARQE DHE GJELBËRIME“

Број/Numër-----

Дата/data -----

С К О П Ј Е, Ш К У П

Neni 11

Mënyra e shfrytëzimit, menaxhimit, ruajtjes dhe shkatërrimit të vulës dhe vulës katrore të Ndërmarrjes, rregullohet me vendim të Drejtorit në pajtim me Ligjin.

Neni 12

Ndërmarrja posedon emblemën e saj . Emblema është vepër e vetme artistike.

Pamja e emblemës është me sa vijon:



4. ПËРФАQËСИМ И ДHE ПРЕZАНТИМ И

Neni 13

Në suaza të autorizimeve të veta, Ndërmarrjen e përfaqëson dhe prezanton Drejtori i Ndërmarrjes.

Drejtori i Ndërmarrjes mundet, me autorizim të shkruar të autorizoj ndonjë person tjetër i cili do ta përfaqësoj Drejtorin e Ndërmarrjes.

Përmbajtjen dhe vëllimin e autorizimit nga paragrafi i mëparshëm, do ta përcaktoj Drejtori i Ndërmarrjes.

5. VEPRIMTARIA E NDËRMARRJES

Neni 14

Ndërmarrja është person juridik i cili realizon veprimtarinë me interes publik, nga fusha e rregullimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit jetësorë dhe të natyrës, si veprimtari komunale me interes publik për Qytetin e Shkupit.

Neni 15

Në qarkullimin juridik dhe në raportet me persona të tretë, Ndërmarrja prezantohet në emër të saj dhe në llogari të saj, vetëm në suaza të veprimtarisë e cila është e regjistruar në regjistrin.

Për obligimet ndaj personave të tretë, të marra në emër të ndërmarrjes dhe në llogari të ndërmarrjes, Ndërmarrja përgjigjet me tërë pronën e saj.

Neni 16

Veprimtaria themelore e Ndërmarrjes është me shifrën që thotë:

- 81.3 – veprimtari shërbyese për rregullim dhe mirëmbajtje të mjedisit jetësorë;

- 81.30 – rregullimi dhe mirëmbajtja e mjedisit jetësorë dhe të natyrës (veprimtari kryesore);

- 02.1 – kultivimi i pyjeve dhe veprimtari tjera lidhur me pylltarinë;

- 02.10- kultivimi i pyjeve dhe veprimtari tjera lidhur me pylltarinë;

Në funksion të veprimtarisë themelore, ndërmarrja realizon edhe veprimtari tjera:

- 01.30 – kultivimi i materialeve për mbjellje

- 01.19 – kultivimi i të mbjellave tjera njëvjeçare

Neni 17

Me qëllim të realizimit të veprimtarisë së saj, dhe në pajtim me Ligji për veprimtaritë komunale, Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për gjelbërimin urban dhe Ligjin për Qytetin e Shkupit, Ndërmarrja i realizon këto aktivitete vijuese:

- E rregullon dhe mirëmban gjelbërimin në Qytetin e Shkupit;

- Realizon ngritjen e sipërfaqeve të reja të gjelbëruara;

- I mirëmban, rregullon dhe mbron Park – pyllin Vodno, Gazi Baba dhe qendrat rekreative sportive.

Neni 18

Ndërmarrja veprimtarinë me interes publik e realizon në mënyrë afatgjate dhe pa ndërprerje dhe gjatë kësaj puna e ndërmarrjes është publike dhe transparente, në pajtim me Ligjin, këtë Statut dhe në pajtim me dispozitat tjera me të cilët rregullohen kushtet dhe mënyra e realizimit të veprimtarisë me interes publik.

Ndërmarrja është e detyruar që të siguroj transparencën në lidhe me raportet financiare gjatë punës së saj materiale – financiare, në pajtim me Ligjin, në pajtim me këtë Statut dhe në pajtim me Standardet ndërkombëtare financiare për sektorin publik.

6. ORGANIZIMI I NDËRMARRJES

Neni 19

Ndërmarrja, gjatë realizimit të veprimtarisë me interes publik, organizohet në mënyrën me të cilën sigurohet:

1. Ligjshmëria, profesionaliteti, efikasiteti dhe leverdia ekonomike gjatë realizimit të aktiviteteve të punës;
2. Uniteti teknik – teknologjik dhe ekonomik i sistemit;
3. Efikasiteti dhe transparenca gjatë funksionimit;
4. Zhvillimi dhe harmonizimi i zhvillimit pronësorë me zhvillimin e përgjithshëm të qytetit të Shkupit;
5. Mbrojtja dhe avancimi i të mirave me interes të përgjithshëm;
6. Plotësimi afatgjatë, i rregullt dhe me cilësi i nevojave të shfrytëzuesve, dhe
7. Pavarësia, barazia në suaza të sistemit dhe lidhshmëria funksionale me sistemet tjera në shtetin tonë dhe në mbarë botën.

Veprimtaria e Ndërmarrjes organizohet në suaza të sektorëve dhe seksioneve, sipas programit dhe planit prej më parë të përcaktuar.

Neni 20

Organizimi i brendshëm i Ndërmarrjes, në mënyrë më të detajuar rregullohet me aktin për organizimin e brendshëm të cilin në propozim të Drejtorit e miraton Këshilli drejtues. Pëlqimin për aktin e jep Ministria për shoqëri informatike dhe për administratë.

Neni 21

Themelimi i sektorëve dhe i seksioneve të reja, bashkimi, anulimi ose ndarja e atyre ekzistuese, realizohet me vendimin për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për organizim të cilin e miraton Këshilli drejtues i Ndërmarrjes, në pajtim me programin e punës dhe në pajtim me nevojat e veprimtarisë së Ndërmarrjes dhe në varësi prej karakteristikave teknike – teknologjike të procesit të punës.

7. ORGANET E NDËRMARRJES

Neni 22

Organet e ndërmarrjes janë:

- Këshilli drejtues,
- Drejtori dhe
- Këshilli mbikëqyrës për kontrollim të punës materiale – financiare.

1. KËSHILLI DREJTUES

Neni 23

Organi i menaxhimit të Ndërmarrjes është Këshilli drejtues.
Këshillin drejtues e emëron dhe shkarkon themeluesi i ndërmarrjes.

Neni 24

Numrin dhe përbërjen e Këshillit drejtues e përcakton Këshilli i Qytetit të Shkupit me aktvendimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues.

Për anëtarë të Këshillit drejtues emërohen përfaqësues nga radhët e ekspertëve të afirmuar dhe të njohur nga fusha e cila është lëndë e funksionimit të ndërmarrjes, duke pasur parasysh edhe përfaqësimin e drejtë të përkatësve të gjitha bashkësive etnike.

Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat 4 (katër) vite.

Për anëtarë të Këshillit drejtues mund të emërohet personi i cili ka përmbushur kushtet e parapara në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike.

Neni 25

Këshilli drejtues ka kryetarin e tij i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit drejtues.

Kryetari i Këshillit drejtues i thërret seancat, kujdeset për realizimin e akteve të Këshillit drejtues dhe i kryen punët tjera të përcaktuara me Rregulloren për punën e Këshillit drejtues.

Neni 26

Këshilli drejtues i Ndërmarrjes:

1. E miraton Statutin e ndërmarrjes;
2. E miraton Programin për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes;
3. E miraton programin për ndërtim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të sipërfaqeve të gjelbëruara publike në territorin e Qytetit të Shkupit;
4. E përcakton politikën afariste;
5. E miraton raportin tremujorë i cili i përmban indikatorët për punën financiare, llogarinë vjetore dhe raportin e punës së Ndërmarrjes;
6. Vendos për shfrytëzimin e mjeteve të realizuara gjatë funksionimit të Ndërmarrjes si dhe për mbulimin e humbjeve;

7. E miraton Programin vjetor për investime;
8. I sjell vendimet për investime;
9. I përcakton çmimet e prodhimeve dhe shërbimeve;
10. Vendos për organizimin e brendshëm të Ndërmarrjes;
11. E përcakton Planin vjetor për punësime në Ndërmarrjen;
12. E sjell aktin për përcaktim të lartësisë së pikës për llogaritjen e pagave për të punësuarit në ndërmarrjen publike;
13. E përcakton pagën themelore dhe shtesat e pagës për të punësuarit;
14. E miraton aktin për sistematizim të vendeve të punës;
15. E miraton Rregulloren për punën e Këshillit drejtues;
16. E miraton Planin financiar të Ndërmarrjes;
17. Formon komisione;
18. Lidh marrëveshjet kolektive;
19. Vendos për udhëtimet zyrtare të Drejtorit të ndërmarrjes në shtete të huaja;
20. Sjell vendime dhe masa për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësorë;
21. Vendos në lidhje me ankesat dhe parashtrësat e të punësuarve në Ndërmarrjen, kur një gjë e tillë është e përcaktuar me ligjin ose me marrëveshjen kolektive;
22. Kujdeset për informimin e punëtorëve;
23. Emëron drejtuesin dhe anëtarët e KM të SHPKTHP themelues i të cilëve është Ndërmarrja, dhe
24. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj, vendimet e Këshillit të Qytetit të Shkupit, dispozitat e këtij Statuti dhe aktet e përgjithshme të Ndërmarrjes.

Në lidhje me aktet e nenit 26 paragrafi 1, alinetë 1, 3, 5, 6, 7, 9, 11 dhe 12 jep pëlqim Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Neni 27

Këshilli drejtues, punon dhe vendos me plot fuqi nëse në seancat marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Vendimet e Këshillit drejtues konsiderohen si të miratuara nëse për të njëjtit kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Çdo anëtarë i Këshillit drejtues ka të drejtën e një vote.

Puna dhe mënyra e vendosjes së Këshillit drejtues, prej së afërmi rregullohen me Rregulloren për punën e Këshillit drejtues.

Neni 28

Këshilli drejtues gjatë sjelljes së vendimeve, me të cilat i shkaktohen dëme ndërmarrjes, përgjigjet në mënyrë të pakufizuar dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara me sjelljen e vendimeve të tilla.

Përgjegjësia e Këshillit drejtues, përcaktohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare, të cilat kanë të bëjnë me organet e menaxhimit.

2 DREJTORI

Neni 29

Organi i udhëheqjes së ndërmarrjes është Drejtori.
Drejtorin e Ndërmarrjes e emëron përkatësisht e shkarkon Kryetari i Qytetit të Shkupit, në bazë të konkursit publik.
Mandati i Drejtorit zgjat 4 (katër) vite.

Neni 30

Drejtori i ndërmarrjes në suaza të drejtave dhe obligimeve të veta:

1. E siguron zbatimin e vendimeve dhe konkluzioneve të Këshillit drejtues;
2. I propozon dhe merr pjesë në zbatimin e politikave themelore dhe afariste, Programin e punës dhe të zhvillimit të Ndërmarrjes;
3. Sjell akte dhe jep urdhëresa për realizim të aktiviteteve punuese nga fushëveprimi i tij, për realizim të aspekteve themelore të Programit për punë dhe zhvillim si dhe jep propozime për ndryshime dhe plotësime të tij;
4. Merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për shfrytëzim dhe përcaktim të mjeteve dhe për menaxhim me mjetet e realizuara gjatë funksionimit të Ndërmarrjes;
5. Realizon harmonizimin e aktiviteteve afariste të Ndërmarrjes;
6. E përfaqëson dhe prezanton Ndërmarrjen, lidh kontrata dhe ndërmerr akte tjera juridike në pajtim me Ligjin;
7. Propozon miratimin e akteve nga fushëveprimi i Këshillit drejtues;
8. E miraton aktin për organizim të brendshëm dhe aktin për sistematizim të vendeve të punës, pas pëlqimit të dhënë më parë nga këshilli drejtues i ndërmarrjes publike dhe nga Ministria për shoqëri informatike dhe për administratë në pjesën e harmonizimit me dispozitat e posaçme ligjore;
10. E përgatit dhe e miraton Planin vjetor për punësime në ndërmarrjen pas pëlqimit të dhënë më parë nga Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe pas pranimit të mendimit nga Ministria për shoqëri informatike dhe për administratë;
11. Sjell vendim për nevojën për themelimin të marrëdhënies së punës, zgjedhjen dhe themelimin e marrëdhënies së punës, aktin për avancim të punëtorëve, përcaktimin e tyre dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, përsosjen profesionale, menaxhimin me efektin e të punësuarve në pajtim me Ligjin;
12. E përcakton vlerën e pikës vlerësuese për pagën themelore dhe miraton rregulloren për pagat në Ndërmarrjen;
13. Është i detyruar që gjatë çdo gjashtë muaj të dorëzoj raportin për punën e ndërmarrjes deri te këshilli drejtues, përkatësisht deri te Kryetari i komunës, përkatësisht deri te Qyteti i Shkupit;
14. E shpall raportin tremujorë i cili i përfshin indikatorët për punën financiare, llogarinë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike në Ueb faqen e internetit të ndërmarrjes publike;

15. E përcjell dhe analizon realizimin e planeve dhe të obligimeve të kontraktuara dhe ndërmerr masa për realizimin e tyre;
16. Jep autorizimin për përfaqësimin e Ndërmarrjes;
17. Formon komisioni që janë në kompetencë të tij;
18. Miraton vendime, urdhëresa, detyrime, autorizime dhe urdhra, me të cilët sigurohet funksionimi i Ndërmarrjes;
19. Sjell vendim për orarin e punës për punëtorët si dhe për kohën e pushimit gjatë angazhimit punues;
20. Miraton Rregullat për rendin dhe disiplinën e punës;
21. Shqipton masa disiplinore dhe miraton vendime për kompensimin e dëmit material;
22. Siguron masa për mbrojtjen e punëtorëve dhe të mjedisit jetësorë, dhe
23. Kryen punë të tjera që janë në pajtim me Ligjin, me këtë Statut dhe me aktet tjera të ndërmarrjes.

Neni 31

Drejtori i ndërmarrjes lidh kontratë me Kryetarin e Qytetit të Shkupit, për rregullim të raporteve me ndërmarrjen, në të cilin në veçanti përcaktohen të drejtat, obligimet dhe autorizimet në pajtim me ligjin.

Drejtori është përgjegjës për rezultatet e punës së tij para Kryetarit të Qytetit të Shkupit.

Drejtori gjatë realizimit të vendimeve me të cilat i shkaktohen dëme ndërmarrjes, përgjigjet pa kufizime për dëmet e shkaktuara gjatë zbatimit të vendimeve të tilla.

Përgjegjësia e Drejtorit përcaktohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare, që kanë të bëjnë me organet e menaxhimit.

Neni 32

Drejtori në emër të Ndërmarrjes është i autorizuar që të lidh kontrata dhe të ndërmerr veprime tjera juridike si dhe të përfaqësoj Ndërmarrjen para gjykatës dhe organeve tjera.

Drejtori lidh kontrata dhe marrëveshje që kanë të bëjnë me realizimin e investimeve të parapara me Programin për investime dhe me Programin për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes.

Neni 33

Drejtori i Ndërmarrjes mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit për të cilin është i zgjedhur, në rastet vijuese:

- Në kërkesë të tij;
- Nëse shfaqet ndonjë prej arsyeve, nga të cilat sipas dispozitave për marrëdhënie pune i ndërpritet marrëdhënia e punës, në pajtim me ligjin;
- Nëse nuk punon dhe nuk vepron në pajtim me ligjin, statutin dhe aktet e ndërmarrjes publike ose nëse pa arsye nuk i zbaton vendimet e këshillit drejtues ose nëse vepron në kundërshtim me të njëjtit;
- Nëse me punën e tij të pandërgjegjshme dhe të parregullt, i shkakton dëme ndërmarrjes publike;

- Nëse i anashkalojnë ose nëse nuk i realizojnë obligimet dhe me këtë do të shfaqen ç'rregullime gjatë realizimit të veprimtarisë me interes publik të ndërmarrjes publike;
- Nëse nuk dorëzojnë raportin në pajtim me nenin 23 – a paragrafi 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike;
- Nëse edhe pas skadimit të afatit të përcaktuar me nenin 23 – a paragrafi 3 të Ligjit për ndërmarrjet publike, nuk i evitojnë mangësitë ose në rastet kur edhe pas këtij afati sërisht manifestohen mangësi dhe / ose humbje gjatë punës financiare, dhe
- Nëse edhe pas skadimit të afatit të përcaktuar në nenin 5 paragrafi 3 dhe në nenin 7 – a paragrafi 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike, nuk e shpallin raportin tremujorë i cili i përfshin indikatorët për punën financiare, llogarinë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike në Ueb faqen e internetit të ndërmarrjes publike.

Neni 34

Deri në emërimin e Drejtorit të ri, Kryetari i Qytetit emëron ushtruesin e detyrës Drejtor i Ndërmarrjes, por jo më gjatë se 6 (gjashtë) muaj.

Neni 35

Drejtori duhet të përcaktojë një të punësuar në suaza të ndërmarrjes i cili do ta zëvendësojë atë në mungesë të tij dhe i cili do të udhëheq me punët rrjedhëse të ndërmarrjes.

Punëtori i cili do ta zëvendësojë Drejtorin e Ndërmarrjes në mungesë të tij ose në rastet e pengesës që ta ushtroj funksionin e tij, me të drejtat dhe obligimet për të cilat do ta autorizojë Drejtori, në pajtim me Ligjin dhe në pajtim me këtë Statut.

3. KËSHILLI MBIKËQYRËS PËR KONTROLLIM TË PUNËS MATERIALE - FINANCIARE

Neni 36

Organi përgjegjës për realizimin e kontrollimit të punës materiale – financiare të Ndërmarrjes është Këshilli mbikëqyrës për kontrollim të punës materiale – financiare (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshilli mbikëqyrës).

Këshillin mbikëqyrës e emëron përkatësisht e shkarkon Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Neni 37

Për anëtarë të Këshilli mbikëqyrës, mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet e parapara në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike.

Mandati i anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës zgjat 4 (katër) vite.

Neni 38

Këshilli mbikëqyrës, punën e tij e kryen në pajtim me kompetencat e parapara në Ligjin dhe Statutin.

Këshilli mbikëqyrës detyrimisht mbledhet së paku 4 herë në vit.

Për rezultatet e kontrollimit të realizuar, Këshilli mbikëqyrës me shkrim e njofton Këshillin drejtues, Këshillin e Qytetit të Shkupit dhe Ministrinë e financave.

Член 39

Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës mund të jenë të pranishëm në seancat Këshillit drejtues.

Neni 40

Këshilli mbikëqyrës për kontrollim, detyrimisht i kontrollon raportet tremujore të cilën në vete i përfshijnë indikatorët e punës financiare, llogaritë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike dhe pas shqyrtimit i dorëzon mendimin deri te Këshilli drejtues.

Këshilli drejtues nuk mund ti miraton raportet tremujore të cilat i përfshijnë indikatorët për punën financiare, llogaritë vjetore dhe Raportin për punën e ndërmarrjes publike, nëse më parë nuk pranon mendim pozitiv nga Këshilli mbikëqyrës për kontrollim.

Neni 41

Anëtarët e Këshilli mbikëqyrës gjatë realizimit të kompetencave të tyre, në rast të shkaktit të dëmeve mbi ndërmarrjen, do të përgjigjen pa kufizime dhe në mënyrë solidare për dëmet e shaktuara gjatë sjelljes së vendimeve të tilla.

Përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, përcaktohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare, që kanë të bëjnë me organet e menaxhimit.

7. ORGANET DHE TRUPAT NDIHMËSE

Neni 42

Me qëllim të funksionimit të suksesshëm dhe me qëllim të përmirësimit të punës së Ndërmarrjes, si dhe me qëllim të realizimit të të drejtave të caktuara, obligimeve dhe përgjegjësi të punëtorëve, në suaza të Ndërmarrjes formohen komisione:

- Komisioni për mbrojtje gjatë punës
- Komisioni për kontrollim të pushimeve mjekësore
- Komisioni për vlerësim dhe shitje të mjeteve të çregjistruara
- dhe komisione të tjera

Në Ndërmarrjen, sipas nevojës mund të formohen edhe komisione dhe trupa tjera permanente dhe të përkohshme.

Komisionet dhe grupet punuese i formohen Këshilli drejtues dhe Drejtori i Ndërmarrjes, secili në fushën e kompetencave dhe autorizimeve të veta.

Kompetenca, mënyra e punës si dhe çështje tjera në lidhje me komisionet dhe trupat punuese, rregullohen me aktin e përgjithshëm të Ndërmarrjes.

8. AKTE TË PËRGJITHSHME TË NDËRMARRJES

Neni 43

Aktet e përgjithshme të Ndërmarrjes janë:

1. Statuti i Ndërmarrjes;
2. Rregullorja për organizim të brendshëm;
3. Rregullorja për sistematizim e vendeve të punës;
4. Marrëveshja kolektive e Ndërmarrjes;
5. Rregullat për rendin dhe disiplinën e punës;
6. Rregullorja për pagat;
7. Rregullorja për mbrojtje gjatë punës, dhe
8. Akte të tjera në pajtim me Ligjin.

Neni 44

Procedura për sjelljen, ndryshimin dhe plotësimin e akteve të përgjithshme, iniciohet në iniciativë të Drejtorit, Këshillit drejtues, Këshillin mbikëqyrës si dhe nga shumica e Sindikatës.

Drejtori, përkatësisht Këshilli drejtues e vlerëson arsyeshmërinë e iniciativës së nisur, nga paragrafi 1 të këtij neni.

Neni 45

Aktet e përgjithshëm duhet të jenë në pajtim me dispozitat ligjore dhe me këtë Statut.

Aktet e përgjithshme, shpallen në tabelën për kumtesa dhe hyjnë në fuqi në ditën e shpalljes, dhe nëse nevojitet marrja e pëlqimit përkatës, akti i përgjithshëm do të zbatohet pas marrjes së pëlqimit.

9. FUNKSIONIMI I NDËRMARRJES

1. Prona dhe mjetet e Ndërmarrjes.

Neni 46

Pronën e ndërmarrjes e përbëjnë të gjithë objektet, mjetet, paratë dhe të drejtat.

Ndërmarrja punon me aq gjiro llogari sa i nevojiten për realizimin e funksioneve të saja.

Neni 47

Mjetet për punën e Ndërmarrjes, sigurohen nga:

- Të ardhurat të cilat i realizon Ndërmarrja;
- Buxheti i Qytetit të Shkupit;
- Mjete kreditore;
- donacionet, projektet dhe nga burime të tjera të mjeteve në pajtim me Ligjin, Vendimet e Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe në pajtim me aktet tjera të themeluesit.

Neni 48

Ndërmarrja është e obliguar që të dorëzoj raporte tremujore deri te Këshilli i Qytetit të Shkupit, të cilët në vete do të përmbajnë indikatorët e punës financiare.

2. Programi për punë dhe zhvillim të Ndërmarrjes.

Neni 49

Me qëllim të funksionimit dhe zhvillimit pozitiv të Ndërmarrjes, përkatësisht për sigurimin e realizimit afatgjatë dhe të vazhdueshëm të veprimtarisë, cilësisë së shërbimeve si dhe zmadhimit të sukseseve gjatë punës, këshilli drejtues miraton Programin për punën dhe zhvillimin e Ndërmarrjes, në propozim të Drejtorit.

Këshilli i Qytetit të Shkupit, jep pëlqim për Programin për punën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Për realizimin e Programit për punën dhe zhvillimin e Ndërmarrjes, është përgjegjës Drejtori i Ndërmarrjes.

10. TRANSPARENCA GJATË FUNKSIONIMIT

Neni 50

Ndërmarrja e realizon dhe zhvillon sistemin e informimit të shfrytëzuesve të shërbimeve, si supozim i rëndësishëm për funksionimin e saj në veprimtarinë komunale në Qytetin e Shkupit.

Aktet të cilat janë me rëndësi për shfrytëzuesit e shërbimeve të Ndërmarrjes, shpallen në “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit”.

Ndërmarrja është e detyruar që për punën e saj, funksionimin dhe për programet zhvillimore me rregull ta njoftoj opinionin përmes mjeteve të informimit publik ose në ndonjë mënyrë tjetër përkatëse.

Neni 51

Ndërmarrja është e detyruar, që rregullisht, në kohë, tërësisht dhe me besueshmëri ti njoftoj punëtorët për të gjitha çështjet që janë me rëndësi për punën dhe zhvillimin e Ndërmarrjes, si dhe për realizimin e të drejtave të tyre.

Punëtorët në Ndërmarrje informohen përmes buletineve, tabelave për kumtesa dhe përmes formave tjera të informimit.

11. SEKRETI AFARIST

Neni 52

Si sekrete afariste, konsiderohen të dhënat të cilat organi me kompetencë i ka shpallur si sekrete afariste dhe si informacione të besueshme, Ndërmarrja të njëjtit ua ka kumtuar organit kompetent.

Të dhënat të cilat konsiderohen si sekrete afariste, mund tu kumtohen personave të tretë, vetëm në bazë të vendimit të sjellë nga Këshilli drejtues i Ndërmarrjes.

Nuk konsiderohet si shkelje e sekretit afarist, nëse të dhënat ose dokumentet për sekrete afariste u kumtohen organeve, organizatave ose personave të cilëve u kumtohen të njëjtit në pajtim me dispozitat ligjore dhe në seancën e Këshillit drejtues, nëse kumtesat e tilla janë të domosdoshme për realizimin e veprimtarisë.

Neni 53

Të dhënat që paraqesin sekret afarist, ruhen dhe akomodohen në mënyrë të ndarë nga dokumentacioni tjetër i Ndërmarrjes.

Shfrytëzimi i të dhënave që paraqesin sekrete afariste, është i lejuar që të shfrytëzohet nga personat e autorizuar vetëm në hapësirat e Ndërmarrjes.

Zbulimi i sekretit afarist, paraqet shkelje të rëndë të obligimeve punuese.

12. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 54

Aktet e përgjithshme të përcaktuara me këtë Statut, do të harmonizohen dhe miratohen në afat prej 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Statuti.

Deri në harmonizimin, përkatësisht miratimin e akteve të përgjithshme nga paragrafi i mëparshëm, do të zbatohen aktet e përgjithshme që janë në fuqi, nëse të njëjtit nuk janë në kundërshtim me këtë Statut.

Neni 55

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet dhe nuk vlen Statuti i Ndërmarrjes me numër 02-207/5 i datës 08.02.2016.

Neni 56

Ky Statut hyn në fuqi dhe do të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Këshilli i Qytetit të Shkupit.

KËSHILLIT DREJTUES
Kryetar
Daniella Nikollova